



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-105

Prishtinë, më 22 prill 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 22 PRILL 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 prill 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 prill 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 prill 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 25 prill 2013, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Interpelanca e ministrit të Shëndetësisë, z.Ferid Agani, sipas kërkesë së deputetes Time Kadrijaj, mbështetur edhe nga 9 deputetë tjerë lidhur me gjendjen në shëndetësinë e Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregun dhe produktet e naftës në Kosovë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për administrimin e punës në zyrë,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës,
8. Zgjedhja e një anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore,
9. Miratimi i Marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve tjera joshumicë dhe zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për debat parlamentar lidhur me gjendjen e pyjeve në Kosovë

Kryesia e shtyu kërkesën e lartshënuar për mbledhjen e radhës.

2. Kërkesa e Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2013

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si Komision Funkcional, që ta shqyrtojë kërkesën e Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2013 dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

3. Procedimi i Projektligjit për fshatin Zym i Hasit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e këtij projektligji, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin për fshatin Zym i Hasit, i hartuar nga grupi i deputetëve nënshkrues, si dhe ta përgatisë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe deklaratën për përafrim të legjislacionit me BE-në të këtij projektligji, në afatin prej një muaji nga dita e pranimit.

4. Kërkesë për mbajtjen e një seance të Kuvendit, në të cilën z. Ekmeleddin Ihsanoglu, sekretari i përgjithshëm i Organizatës për Bashkëpunim Islamik do t'u drejtohet me një fjalë rasti deputetëve të Kuvendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, në parim vendosi që më 2 maj 2013, z.Ekmeleddin Ihsanoglu, sekretar i përgjithshëm i Organizatës për Bashkëpunim Islamik, t'u drejtohet me një fjalë rasti deputetëve të Kuvendit, por për këtë çështje paraprakisht të konsultohet edhe Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare e Kuvendit.

5. Kërkesa e deputetëve Blerta Deliu-Kodra dhe Bekim Haxhiu, mbështetur edhe nga 5 deputetë tjerë, për seancë solemne për nderim të heroit-gjeneralit Ilaz Kodra dhe gjithë dëshmorëve dhe pjesëtarëve të Brigadës 114 “Fehmi Lladrovci”

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, vendosi që më 30.4.2013, të mbahet një seancë solemne në nderim të heroit-gjeneralit Ilaz Kodra dhe gjithë dëshmorëve dhe pjesëtarëve të Brigadës 114 “Fehmi Lladrovci”.

6. Kërkesa e deputetit Ramiz Lladrovci, i mbështetur edhe nga 6 deputetë tjerë, për seancë solemne në nderim të “Betejës së Prekazit të Epërm”, të udhëhequr nga Tahir e Nebih Meha

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, vendosi që më 13.5.2013, të mbahet një seancë solemne në nderim të “Betejës së Prekazit të Epërm”, të udhëhequr nga Tahir e Nebih Meha.

7. Kërkesa e deputetit Fadil Demaku, i mbështetur edhe nga 6 deputetë tjerë, për seancë solemne në nderim të “Betejës së Llapushnikut”

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, vendosi që më 9.5.2013, të mbahet një seancë solemne në nderim të “Betejës së Llapushnikut”.

Lidhur me pikat e rendit të ditës nr. 5,6 dhe 7, që kanë të bëjnë me kërkesë për seancë solemne diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit; Adem Grabovci, kryetar i G/P të PDK-së; Ardian Gjini, kryetar i G/P të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

8. Kërkesa e deputetes Alma Lama për procedimin e Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet (përsëri) nga Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision Funkcional, që në pajtim me Rregulloren e Kuvendit ta procedojë në afat sa më të shkurtër Projektligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë për mbledhje plenare.

9. Marrëveshja e deputetëve nga radha e komuniteteve tjera joshumicë dhe joserbe për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit me rotacion nga këto komunitete

Për marrëveshjen e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Adem Grabovci, kryetari G/P të PDK-së; Ardian Gjini, kryetar i G/P të AAK-së, dhe Myfera Shiniq, kryetare e G/P 6+, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi për marrëveshjen e lartshënuar, e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare të radhës më 25 prill 2013.

10. Kërkesa e kryetarit të Komisionit për Integritet Evropian, z. Lutfi Haziri, për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimit zyrtar i kryetarit të Komisionit për Integritet Evropian, z. Lutfi Haziri, dhe kryetarit të Komisionit për Politikë të Jashtme, z. Albin Kurti, për të marrë pjesë në kremtimin e 70-vjetorit të emetimit të emisionit të parë në gjuhën shqipe të 'Zërit të Amerikës', në Uashington - SHBA, prej 6-8 maj 2013.

2. Kuvendi mbulon vetëm pjesën (30 %) të mëdijes.

11. Dokumentacioni i procesit të privatizimit të PTK-së

Kryesia, pasi u njoftua lidhur me dokumentacionin e përgatitur që ka të bëjë me procesin e privatizimit të Postë-Telekomunikacionit të Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës t'u shpërndahet materiali që ka të bëjë me procesin e privatizimit të PTK-së, për njoftim.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale